

VENDIM
Nr. 715, datë 26.11.2025

**PËR SHPALLJEN E DISA ZONAVE ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E
EKONOMISË MALORE NË BASHKINË MAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “zonë me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore” në territorin e Bashkisë Mat, si më poshtë vijon:

a) Zona zhvillimore nr. 1, zona e liqeneve të Gërmanit, fshati Selixë, pjesë e Njesisë Administrative Koms, me sipërfaqe 2 051 282 (dy milionë e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) m², sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto;

b) Zona zhvillimore nr. 2, zona ish-Vila e Zogut, fshati Selixë, pjesë e Njesisë Administrative Koms, me sipërfaqe 1 585 237 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë) m², sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto;

c) Zona zhvillimore nr. 3, zona e kurorës së fshatit Selixë, pjesë e Njesisë Administrative Koms, me sipërfaqe 2 564 391 (dy milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) m², sipas hartës në sistemin KRGJSH të paraqitur mbi ortofoto.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së këtyre zonave përcaktohen në hartën treguese, sipas sistemit KRGJSH, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Llojet e aktiviteteve, që do të zhvillohen në këtë zonë, janë:

a) të zhvillimit ekonomik;

b) industriale;

c) turistike.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Mat për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



PLAN VENDOSJA E ZONES ZHVILLIMORE (TERRITORI ISH VILA E ZOGUT)
SH---- 1:10000 SISTEMI KOORDINATIV KRRGJSH


SIPERFAQJA : $1585237 \text{ M}^2 = 158.5237 \text{ Ha}$





PLAN VENDOSJA E ZONES ZHVILLIMORE (LIQEJT E GERMANIT)
SH---- 1:10000 SISTEMI KOORDINATIV KRRGJSH

SIPERFAQJA :2051282 M² =205.1282 Ha



PLAN VENDOSJA E ZONES ZHVILLIMORE (KURORA E FSHATIT SELIXE)
SH---- 1:10000 SISTEMI KOORDINATIV KRRGJSH

SIPERFAQJA :2564391 M² =256.4391 Ha

